



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Senati Akademik

Nr. 1125 Prot

Shkodër, më 29 . 03 .2024

V E N D I M

Nr. 92 datë 29 03 2024

**"MBI MIRATIMIN NË PARIM TË BUXHETIT TË VITIT 2024  
DHE DISA ZËRAVE BUXHETORE"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), Ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", VKM nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, Udhëzimit nr.1 datë 24.01.2024 të MFE "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", Udhëzimit të Përbashkët nr. 20, datë 20.9.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë",(i ndryshuar), Senati akademik në mbledhjen e datës 29.03.2024

**Vendosi**

1. Miratimin në parim të buxhetit 2024.
2. Miratimin e investimeve: 1."Për paisje për inventar ekonomik", 2. "Furnizim vendosje kondicionerësh", 3. "Supervizim i ndriçimit të objekteve dhe tabelave emërtuese të ndërtesave", 4. "Investim për ndriçim të objekteve dhe tabelave emërtuese të ndërtesave, 5. "Rikonstruksion çatia e FSHE", 6. "Paisje elektronike".
3. I përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE E SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Rajmonda Këçira**

